speciale

QËNDRIMI / Olsi Jazexhi thotë se ngritja e monumentit është kërcënim për laicitetitin e shtetit

OLSI JAZEXHI

Monumenti, në vazhdën e fushatës kristianizuese

Katër shoqata në Shkodër ka kërkuar që monumenti i Nënë Terezes të mos vendoset në ambiente publike në Shkodër. Si studiues i Islamit në Shqipëri, si mund ta sqaroni këtë qëndrim?

Unë nuk mund të përgjigjem për deklaratat e organizatave myslimane në Shkodër. Por di të them që në Shqipërinë e viteve të fundit, një fushatë teokratizimi ndaj institucioneve publike po bie shumë në sy. Duke filluar këtu që nga deklarata e presidentit Moisiu në Londër, ku u deklarua se Islami nuk është fe burimore, e më tej, përpjekjet e ministrit të Kulturës, Leskaj, për të konvertuar një xhami 550-vjeçare në kishë, apo deklarata të tjera që hidhen nga disa politikanë që pretendojnë se Skënderbeu, heroi kombëtar i shqiptarëve, ka qenë atlet i krishtërimit; janë disa nga faktorët që shkaktojnë shumë tension në mesin e atyre shqiptarëve myslimanë, që ndiehen të përjashtuar nga jeta publike dhe kombëtare në Shqipëri.

Këto tensione ndjehen shumë edhe pas faktit kur sot shihet sesi komunitetet e tjera fetare në Shqipëri, gëzojnë katedrale, radio, universitete dhe investime kolosale në vend. Ndërsa myslimanët jo vetëm që nuk kanë pronat e tyre të kohës së parakomunizmit të kthyera, por shumë njerëz nëpër mediat tona, herë pas here lëshojnë mesazhe fashiste dhe islamofobike kundër identitetit të myslimanëve shqiptarë dhe pro-krishtërimit katolik, i cili identifikohet me Perëndimin. Këta njerëz duket sikur shpesh shkojnë në unison me politikën tonë, e cila sikur të mos i bëjë fare përshtypje islamofobia e tyre, nuk e sheh kurrë të distancohet nga ata.

Tezat që janë hedhur nga shkrimtarë të mëdhenj të monizmit në Shqipëri, siç janë ato që pretendojnë se feja e parë e shqiptarëve ka qenë katolicizmi janë deklarata, të cilat kanë krijuar ndjenjën e përjashtimit dhe bezdisë mes shumë myslimanësh shqiptarë.

Edhe pse myslimanët e Shqipërisë janë koshientë që Nënë Tereza ka qenë një bamirëse e madhe, siç ka qenë edhe Dervish Hatixheja jonë, përdorimi i këtyre njerëzve të mirë nga disa politikanë për përfitime politike, duke vendosur bustet vetëm të Nënë Terezës, në rastin tonë vend e pavend, vetëm se i bashkohet fushatës kristianizuese të vendit.

Myslimanët ndiehen keq kur ata shohin sesi në vendin e tyre sheshe, shkolla, spitale, universitete, aeroporte, emërohen me emra shenjtësh katolikë, ndërsa askush nuk është kujtuar deri më sot të emërojë qoftë edhe një rrugë në Tiranë me emrin e kryehoxhës së tyre, të ndjerit, Hafiz Sabri Koçi.

Për më tepër vendosja e busteve të shenjtorëve katolikë, jo vetëm që provokon myslimanët dhe njerëzit me besime të tjera, por i shkakton vendit humbjen e laicitetit, dhe një përzierje të pakuptimtë të fesë me jetën laike të qytetarëve tanë, të cilën bejlerët dhe agallarët që formuan shtetin tonë në fillimet e shekullitXX, e bënë me shumë mund dhe pasion.

Në ditët tona, deklarata e Vaso Pashës, "Feja e shqyptarit asht shqyptaria" duket sikur po kthehet në "feja e shqiptarit është katolicizmi" (kur dihet që të parët tanë kanë qenë paganë). Ky është një zhvillim shumë shqetësues, për të cilin unë dua që t'i kuptojmë sa më mirë myslimanët shkodranë.

Në deklaratë thuhej se Nënë Tereza është një shenjtore katolike, ndaj një monument i saj duhet vënë vetëm në ambiente religjioze katolike. Nuk është mohim i figurës multidimensionale të Nënë Terezës?

Nënë Tereza mund të ketë qenë figurë multidimensionale. Por këtu ne mund të flasim për aspektet pozitive, por edhe problematike të saj sa të duam. Në Perëndim ekzistojnë shumë libra që flasin për jetën e saj, bamirësitë, por edhe kontestimet që shumë indianë kanë pasur ndaj politikave katolicizuese të urdhrit të saj në Indi, apo edhe veprimtarë të tjerë të të drejtave njerëzore në lidhje me takimet e saja me diktatorë të ndryshëm. Megjithatë, ne në Shqipëri ngaqë i duam shumë njerëzit me famë, flasim vetëm për anët e mira të tyre. Në fund të fundit, ajo në botë më shumë njihet si figurë fetare, e cila ka bërë përpjekje kolosale për përhapjen e katolicizmit. Megjithatë, mbivlerësimi i figurës së saj, siç është edhe rasti i shpalljes së ditës së lumturimit të Nënë Terezës si festë kombëtare në Shqipëri, është një servilosje e tepruar nga politikanët tanë, të cilët duke imponuar këtë rit katolik mbi të gjithë shqiptarët, padashje po fyejnë shqiptarët e përkatësive jokatolike, të cilët thjesht e kanë të vështirë të besojnë në mrekullitë që Kisha Katolike i atribuon shërbestarëve të saj të dalluar. Sikur politikanët tanë të kishin qenë me të vërtetë kaq të dhënë pas Nënë Terezës, unë habitem pse nuk kanë shpallur festë kombëtare ditëlindjen e saj, por shkojnë dhe përziejnë kombin shqiptar me praktika fetare katolike.

Pavarësisht figurës multidimensionale të Nënë Terezës, mendoj se politika shqiptare duhet të jetë shumë vigjilente për të ruajtur asnjanësinë dhe mospërzierjen e fesë me politikën në Shqipëri. Unë mendoj se ky procesi i strapacuar i 'nënëterezizimit' të politikës sonë, jo vetëm që përbën një kalim të limiteve nga politikanët tanë, të cilët këto përpjekje i bëjnë për të rrëfyer veten e tyre sa më servilë ndaj disa NGO-ve që operojnë në Ballkanin perëndimor, por ata harrojnë se me këtë servilizëm ata po thyejnë laicitetit e shtetit dhe përjashtimin e detyrueshëm që ai duhet t'i bëjnë fesë nga jeta publike: për të ruajtur në këtë mënyrë asnjanësinë dhe ndjenjat e bashkësive të ndryshme fetare që ekzistojnë në vend.

Olsi Jazexhi, studiues i çështjeve fetare në Shqipëri

Pas këtij reagimi, si dhe ngjarjes së xhamisë në kalanë e Shkodrës, duket se klima e marrëdhënieve ndërfetare në këtë qytet nuk po shkon për mirë. Ka rrezik për t'u injektuar një klimë e tillë edhe në qytetet e tjera dhe në debatet publike?

Ndoshta. Por e gjithë kjo varet nga sjellja dhe kuptimi i ndjenjave të besimeve në vend që ministria dhe ministri ynë i Kulturës duhet të tregojë. Kam vënë re që në kohët e fundit shumë konflikte që po ndizen në qytetin e Shkodrës, kanë buruar nga disa iniciativa të pamenduara mirë, që Ministria e Kulturës ka marrë ndaj qytetin verior, ku ndasitë dhe përkatësitë fetare janë çështje shumë më të ndjeshme sesa fjala bie në vendin nga është origjina e ministrit tonë.

Për më tepër **vendosja** e busteve të shenjtorëve **katolikë**, jo vetëm që provokon **myslimanët** dhe njerëzit me **besime** të tjera, por i shkakton vendit humbjen **e laicitetit**

A nuk do të ishte më mirë që myslimanët të përqëndronin energjitë në disa kërkesa më thelbësore për ta, siç është çështja e xhamisë së madhe në Tiranë, pronat e Komunitetit Mysliman, si dhe një ligjërim publik më korrekt ndaj Islamit?

Padyshim. Megjithatë siç dihet sot, Komunitetit të Myslimanëve shqiptarë i mungon organizimi dhe ekspertiza për të arritur pretendime të këtilla. Fati i keq është se politika ka luajtur dhe do vazhdojë të luajë më Islamin në Shqipëri, pasi fatkeqësisht myslimanët shqiptarë nuk kanë pas vetes së tyre ndonjë superfuqi, siç fetë e tjera kanë. Por reagimet që po vinë nga myslimanët kohët e fundit nuk janë se kjo gjë dëshirohet nga ata, por politika vazhdon t'i trajtojë ata si qytetarë të dorës së dytë, të ndërhyjë në çështjet e tyre të brendshme dhe për më tepër, të provokojë një grup të madh të shoqërisë shqiptare, i cili në 9 vitet e fundit të regjimit socialist, shpesh herë është identifikuar me pozitën aktuale dhe trajtuar si komunitet i dorës së dytë. ■

Kronologjia e një situate të tendosur

18 dhjetor 2005
Deklaratë e Myftinisë së Shkodrës për kryqet në Bushat. "Konstatojmë se prej disa kohësh në tri kodrat që rrethojnë Bushatin janë vendosur disa kryqe të mëdhenj. Kërkojmë që të hiqen, pasi cenojnë rëndë bashkëjetesën dhe harmoninë fetare", - thanë përfaqësues të Komunitetit Mysliman.

23 dhjetor 2005
Deklaratë e monsinjor Luçian Avgustinit Kryqet në Bushat nuk kanë sesi të hiqen, pasi ata i kanë vendosur besimtarët. Ato kryqe nuk janë vendosur as nga ne e as me dijeninë tonë, por vetë populli i zonës së Bushatit, i cili mund të vendosë vetë për praninë e tyre apo jo.

26 dhjetor
Meshë e mbajtur në kishën-xhami.
Disa dhjetëra besimtarë katolikë kanë sfiduar kohën e keqe, duke ndjekur meshën e celebruar nga dom Gjovalin Sukaj. "Nuk ka kompromis me të keqin, askush nuk mund të na cenojë", - deklaronte kleriku i ri në meshën e mbajtur me rastin e Shën Shtjefnit.

23 dhjetor 2005
Ministri i Kulturës, Leskaj, vizitë në Bashkinë e Shkodrës
Lidhur me problemin e kalasë ministri deklaroi: "U kujtoj disa grupimeve të cakjtjes së vlerave monumentale të kalasë Rozafa. Jepni të gjithë kontributin tuaj për zbatimin e projektit të restaurimit të kishës-xhami në kalanë e Shkodrës".

10 janar 2006
Rrëzimi i kryqit në Bushat
Bashkëjetesa fetare në rajonin e Shkodrës, aq e lëkundur prej më shumë se një muaji, ka marrë një goditje të rëndë pikërisht në ditën kur besimtarët myslimanë festonin Kurban Bajramin dhe vetëm pak orë pas vizitës në këtë qytet të Presidentit të Republikës, Alfred Moisiu. Një nga tre kryqet e vendosura në kodrat përreth Bushatit, fshatit 15 km larg kryeqendrës së veriut, është sharruar dhe më pas rrëzuar në mes të ditës nga një grup personash akoma të paidentifikuar nga policia

12 janar 2006
Qetësohet situata në Bushat
Të mbledhur në mjediset e komunës klerikë, përfaqësues të pushtetit vendor, si dhe një numër banorësh nga të dy besimet e përfshira në konfliktin e kryqit, kanë garantuar se në zonën e Bushatit klima mes komunitetit katolik dhe atij mysliman është tërësisht paqësore, ashtu si ka qenë për shekuj me radhë.

24 shkurt 2006
Drejtori i Institutit të Monumenteve vizitë në Shkodër
Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Monumenteve të Kulturës, Apollon Baçe, deklaroi: "Nuk na nevojitet një status për përjashtimin e pretendimeve të komuniteteve fetare lidhur me objektin kishë-xhami, pasi ky objekt është monument kulture në pronësi të institutit tonë, ndaj dhe nuk presim miratimin e të tjerëve për fillimin e punimeve".